

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Burrëria e devotshme<sup>1</sup> / *el-Futuwwu* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"تَهُمُ فِتْيَةٌ آمَنُوا بِرَبِّهِمْ وَزِدْنَاهُمْ هُدًى"

“Ata qenë djem që besuan në Zotin e tyre dhe Ne ua shtuam udhëzimin.” (el-Kehf, 13)

Thelbi i burrërisë së devotshme është që të mos ndiesh në veten tënde ndonjë përparësi ose meritë. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë:

---

<sup>1</sup> *Futuwwu* (përkthim i drejtpërdrejtë: burrëria djaloshare) është një koncept artificial. Në Shpallje, s'ka lavdërim apo dënim të këtij termi. Dhe asnjëherë nuk është përmendur në këtë formë të emrit foljor. Ajo çfarë është përmendur në Shpallje, natyrisht në një kontekst pozitiv, është emri nga i cili përftohet *futuwwu*, që është *feta* / djalosh ose shumësi i saj. Fjala *feta* kishte një konotacion pozitiv në Arabinë e epokës para-islamike. Kjo fjalë është përdorur nganjëherë për të treguar një djalosh ideal, që demonstroi tiparet më të pëlqyeshme që priteshin nga një komunitet fisnor i Arabisë, sidomos trimërinë, bujarinë, dhe besnikërinë. Nganjëherë janë përfshirë edhe virtyte të tjera, po ashtu dhe vese, si: ekstravaganca, prija e tepërt, etj. Pas Islamit, mjeshtërit e sufizmit sunit u orvatën ta tërhiqnin vëmendjen në pozitivitetin e natyrshëm të fjalës. Ata deshën ta ndryshonin përdorimin e saj për të treguar aspekte të caktuara pozitive, të zakonshme për të rinjtë, si: trimëria, bujaria, dhe besnikëria. Disa nga kjo zhvilluan një kod të plotë të sjelljes, që përfaqëson burrërinë morale e shpirtërore, trimërinë dhe zemërgjerësinë që pritet nga një ndjekës i shtegut të pastrimit shpirtëror. Pastaj kjo fjalë është përdorur edhe për organizata paramilitare, shoqëri ritualiste për të cilën atyre iu desh të shpiknin zinxhirë të transmetimit. Prandaj dhe disa dijetarë, siç qe Ibn Tejmije, dënuan këto devijime, ndërsa pranuan virtytet dhe nismat e pastra. Më në fund, në disa vende, si në Egjipt, fjala vjen, termi *futuwwu* është përdorur për rrugaçët e dhunshëm, që frikësonin lagje të tëra, ndonëse nganjëherë silleshin burrërisht. Ajo për çfarë shejhu (el-Harawi) përdor këtë term, është koncepti i burrërisë së devotshme, që pritet nga një ndjekës i shtegut të pastrimit shpirtëror. Shumë nga konceptet e trajtuara të *futuwwu* përfshihen në shkallë (stacione) të tjera, por këndi nga i cili trajtohen është i ndryshëm. Gjallëria rinore është përdorimi kryesor për të përshkruar një formë të gjallërisë morale e shpirtërore, që mund të mbahet vetëm nga besimtarët më të fortë.

- Përmbajtja nga mosmarrëveshjet (zënkat)
- Shpërfillja e rrëshqitjeve (të të tjerëve)
- Harrimi i dëmit (që të tjerët ta bëjnë)

Niveli i dytë:

- T'i afrosh ata që të largojnë
- Të tregosh bujari ndaj atyre që të lëndojnë
- T'u kërkosh falje atyre që të bëjnë zullum<sup>2</sup>

Dhe në këtë të tregosh butësi, jo vetëm të përmbahesh; të tregosh përdëllim, jo vetëm të durosh.

Niveli i tretë:

- Të mos e kesh rrugëtimin tënd (në pastrimit shpirtëror) të varur nga provat<sup>3</sup>
- Të mos njollosësh përgjigjen tënde me dëshirën për kompensim
- Të mos shohësh ndonjë formë në dëshmimin tënd (të kësaj shkalle)

Ta dish se, ai që e bën armikun të kërkojë ndërmjetësim dhe nuk tregohet tepër i turpshëm që ta dëgjojë kërkimin e faljes nga ai, s'ka të bëjë asgjë me burrërinë e devotshme. Në dijen e elitës së besimtarëve, ai që kërkon Dritën e së Vërtetës nëpërmjet arsyes, nuk ka hise në burrërinë e devotshmërisë.

---

<sup>2</sup> Ti mund t'i kesh bërë ata që të bëjnë zullum ose të kesh kontribuar në këtë. Nëse jo drejtpërsëdrejti, kujto që, ai i cili i bëri të tjerët të të dëmtojnë, me gjasë e bëri këtë ngaqë ti e ke merituar. Në kërkimin e faljes që ti ua bën atyre, pranon se gjynahu yt ndaj Allahut ose ndaj dikujt tjetër i bëri ata që të fitojnë një gjynah ndaj teje.

<sup>3</sup> Ai që ka nevojë për provë për t'u nisur drejt Tij, nuk meriton të cilësohet me burrëri të devotshmërisë. Sepse Ai është provë për Të dhe për gjithçka tjetër.